



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

TERMAT E REFERENCËS

SKEMA E SUBVENCIONEVE PËR START-UP DHE NDËRMARRJE PËR RICIKLIM DHE EKONOMI QARKORE



1. HYRJE

Menaxhimi i mbeturinave dhe rritja e riciklimit janë ndër sfidat kryesore mjedisore në Republikën e Kosovës. Një pjesë e konsiderueshme e mbeturinave ende përfundon në deponi ilegale ose në vende të papërshtatshme, ndërsa potenciali i materialeve të riciklueshme nuk shfrytëzohet mjaftueshëm.

Kjo skemë synon të përdorë fondet publike për të mbështetur ide dhe biznese të reja që e shohin mbeturinën si burim dhe krijojnë zgjidhje konkrete për parandalimin, ndarjen, ripërdorimin, përpunimin dhe riciklimin e saj.

Fokusi kryesor i skemës është mbështetja e start-up dhe ndërmarrjeve të reja që kanë një ide të qartë, të realizueshme dhe me potencial për të krijuar ndikim të matshëm mjedisor dhe ekonomik. Përparësi do të kenë projektet që mund të demonstrohen, të funksionojnë në praktikë dhe më pas të zgjerohen në treg ose të replikohen në komuna të tjera.

2. BAZA LIGJORE

Kjo skemë e mbështetjes është në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, në veçanti:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit; (Neni 79);
- Ligji për Mbeturinat; (Nenet 31, 59, 60)
- Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; (Neni 53);
- Ligji për Ndarjet Buxhetore
- Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave dhe dokumentet përkatëse të zbatimit.

3. QËLLIMI I SKEMËS

Qëllimi i skemës është të mbështesë financiarisht start-up dhe ndërmarrje të reja që zhvillojnë dhe zbatojnë ide për parandalimin, ripërdorimin, ndarjen, përpunimin dhe riciklimin e mbeturinave, duke krijuar njëkohësisht produkte, shërbime ose modele biznesi të qëndrueshme.

Skema synon që financimi publik të shërbejë si shtysë për zhvillimin e ideve me potencial real, duke krijuar rezultate të matshme dhe duke iniciuar investime të mëtejshme.

4. OBJEKTIVAT

4.1 Objektivi i Përgjithshëm

Të kontribuohet në mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në Republikën e Kosovës përmes mbështetjes financiare të projekteve që përmbajnë zgjidhje të qëndrueshme dhe inovative duke zvogëluar sasinë e mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe rritjen e riciklimit dhe ripërdorimit në Kosovë.

4.2 Objektivat Specifike

Skema synon të arrijë këto objektiva specifike:

- të mbështesë zhvillimin dhe testimin e ideve të reja që ofrojnë zgjidhje konkrete për mbeturinat dhe riciklimin;
- të rrisë kapacitetet për ndarjen, mbledhjen, përgatitjen për riciklim dhe përpunimin e materialeve;
- të nxisë krijimin e produkteve dhe shërbimeve të reja nga materiale të ricikluara ose të ripërdorura;
- të mbështesë zgjidhje për kategori të ndryshme të mbeturinave, përfshirë plastikën, tekstilin, mbeturinat organike, gomat dhe të tjera.
- të krijojë vende pune dhe aktivitete të lidhura me ekonominë qarkore;
- të gjenerojë rezultate të matshme mjedisore dhe modele që kanë potencial për t'u zgjeruar ose replikuar.

5. PRIORITETET TEMATIKE

Projektet duhet të kenë një lidhje të qartë me mbeturinat dhe riciklimin. Inovacioni, qëndrueshmëria dhe potenciali për rritje do të vlerësohen në të gjitha prioritetet dhe nuk trajtohen si kategori të ndara.

Prioriteti 1 | Parandalimi, ripërdorimi, ndarja dhe riciklimi i mbeturinave

- ndarja e mbeturinave në burim dhe përgatitja e tyre për riciklim;
- zgjidhje për rritjen e sasisë së materialeve të mbledhura dhe të riciklueshme;
- ripërdorimi, riparimi dhe zgjatja e ciklit jetësor të produkteve;
- sisteme ose shërbime që reduktojnë sasinë e mbeturinave që dërgohen në deponi.

Prioriteti 2 | Përpunimi i kategorive specifike të mbeturinave

- plastikë dhe ambalazh;
- tekstile;
- mbeturina organike dhe kompostim;
- goma dhe materiale të tjera të vështira për riciklim;

Prioriteti 3 | Produkte, shërbime dhe modele të reja biznesi nga mbeturinat

- zhvillimi i produkteve të reja nga materiale të ricikluara ose të ripërdorura;
- zhvillimi i prototipeve dhe testimi i zgjidhjeve të reja;
- teknologji dhe pajisje që përmirësojnë efikasitetin e riciklimit ose përpunimit;
- platforma ose zgjidhje digjitale që mundësojnë gjurmimin, grumbullimin, ndarjen ose tregtimin e materialeve të riciklueshme;
- modele biznesi që krijojnë treg për materialet e ricikluara dhe nxisin ekonominë qarkore.

6. PËRFITUESIT E PRANUESHËM

Skema është e orientuar kryesisht drejt start-up-ve dhe ndërmarrjeve të reja që zhvillojnë zgjidhje të lidhura drejtpërdrejt me mbeturinat, riciklimin dhe ekonominë qarkore.

- Start-up të regjistruara në Republikën e Kosovës;
- Ndërmarrje të vogla të regjistruara në Republikën e Kosovës që prezantojnë një produkt, shërbim, proces ose model të ri në fushën e skemës;

7. KUSHTET MINIMALE PËR APLIKIM

- të jetë subjekt juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës;
- të veprojë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi;
- të ketë përmbushur detyrimet tatimore dhe ligjore, sipas kërkesave të thirrjes;
- të mos jetë i dënuar për keqpërdorim të fondeve publike;
- të mos ketë konflikt interesi me autoritetin përgjegjës;
- të paraqesë një ide të qartë dhe konkrete, me problem të identifikuar, zgjidhje të propozuar dhe mënyrë të matjes së rezultatit;
- të dëshmojë se projekti është teknikisht dhe financiarisht i realizueshëm.

8. AKTIVITETET E PRANUESHME

Në varësi të natyrës së projektit, mund të financohen:

- blerja e pajisjeve, makinerive dhe mjeteve të nevojshme për ndarje, përpunim ose riciklim;
- pajisje për kompostim dhe përpunim të mbeturinave organike;
- zhvillimi dhe testimi i prototipeve;
- zhvillimi ose përshtatja e teknologjive dhe proceseve të riciklimit;
- zhvillimi i produkteve të reja nga materiale të ricikluara ose të ripërdorura;
- softuerë dhe zgjidhje digjitale të lidhura drejtpërdrejt me projektin;
- testime teknike, analiza laboratorike, certifikime ose standardizime të nevojshme për produktin/procesin;
- shpenzime të tjera të domosdoshme dhe të arsyeshme që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e projektit dhe përcaktohen në thirrjen publike.

9. BUXHETIMI

Shuma e përgjithshme e subvencionimit është 200.000.00 euro.

9.1 Niveli i subvencionimit

Vlera minimale dhe maksimale e subvencionit për një projekt do të jetë nga 5,000 € deri në 20,000 €.

MMPH ka të drejtën të ndryshojë kufijtë financiarë në përputhje me buxhetin e disponueshëm dhe prioritetet e thirrjes.

10. KRITERET E VLERËSIMIT

Në vlerësimin e idesë, aplikuesi duhet të paraqesë, zgjidhje të qartë dhe konkrete për një problem të caktuar të menaxhimit të mbeturinave, të dëshmoj karakterin inovativ të zgjidhjes, të paraqes zbatueshmërinë e saj në praktikë, potencialin për të krijuar aktivitete ekonomike dhe mundësinë e zgjerimit apo replikimit të saj.

Ndikimi dhe realizueshmëria e projektit janë elemente kryesore të vlerësimit. Komisioni duhet të vlerësojë nëse ideja adreson një problem real, nëse zgjidhja është e qartë dhe nëse ka potencial të krijojë ndikim të matshëm dhe aktivitete ekonomike të qëndrueshëm.

Kriteri i vlerësimit	Pikët e vlerësimit
Ndikimi i projektit në reduktimin e mbeturinave	30
Realizueshmëria teknike dhe plani i zbatimit	25
Inovacioni / Ideja kreative	15
Qëndrueshmëria e modelit të biznesit dhe potenciali për rritje/shkallëzim	15
Arsyeshmëria e buxhetit dhe efektiviteti i kostos	10
Përfshirja e komunitetit (banorët e lagjes, fshatit etj.)	5
Gjithsej	100

Pragu minimal 70 pikë.

Në rast të pikëve të barabarta, përparësi i jepet projektit që demonstroi ndikim më të madh në reduktimin ose riciklimin e mbeturinave, ide më të qartë dhe më të realizueshme, si dhe potencial më të madh për rritje/shkallëzim.

11. PROCESI I APLIKIMIT

Procesi i aplikimit zhvillohet në fazat e mëposhtme:

Fazat	Veprimet që zbatohen
Faza I Publikimi i Thirrjes	Ministria publikon thirrjen, ToR, formularët, afatet, kriteret e vlerësimit dhe dokumentacionin e kërkuar.
Faza II Dorëzimi i aplikimeve	Aplikimet dorëzohen brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar në thirrje. Aplikimet pas afatit nuk pranohen.
Faza III Verifikimi administrativ	Kontrollohet afati, dokumentacioni, statusi i aplikuesit dhe pranueshmëria e projektit. Vetëm aplikimet që kalojnë këtë fazë vazhdojnë.
Faza IV Vlerësimi teknik	Komisioni vlerëson idenë, ndikimin mjedisor, realizueshmërinë, modelin e biznesit dhe buxhetin sipas matricës së pikëzimit.
Faza V Përzgjedhja dhe miratimi	Përgatitet lista e projekteve të rekomanduara dhe i paraqitet autoritetit përgjegjës për miratim.
Faza VI Njoftimi i përfituesve	Aplikuesit njoftohen për rezultatin e procesit në përputhje me procedurat dhe afatet e thirrjes.
Faza VII Nënshkrimi i marrëveshjes	Përcaktohen shuma, aktivitetet, afatet, disbursimi, raportimi, monitorimi dhe kushtet për kthimin e mjeteve kur aplikohet.

12. KOMISIONI I VLERËSIMIT

Komisioni emërohet nga autoriteti përgjegjës i Ministrisë dhe përbëhet nga së paku tre (3) ose pesë (5) anëtarë me njohuri relevante në mjedis, menaxhim të mbeturinave, ekonomi/biznes, financa publike, teknologji ose menaxhim projektsh.

Anëtarët duhet të deklarojnë konfliktin e interesit dhe të respektojnë parimet e paanshmërisë, konfidencialitetit dhe transparencës. Procedurat e punës dhe mënyra e vendimmarrjes përcaktohen me aktin përkatës të Ministrisë.

13. MONITORIMI

Monitorimi bëhet për të verifikuar zbatimin e projektit, përdorimin e fondeve dhe arritjen e rezultateve të përcaktuara në marrëveshjen e subvencionit.

- shqyrtimi i raporteve narrative dhe financiare;
- verifikimi i faturave dhe dokumentacionit;
- vizita në terren, kur është e nevojshme;
- verifikimi i pajisjeve, prototipeve, investimeve dhe rezultateve;
- kërkimi i informatave shtesë kur kërkohet.
- Rekomandohet që pagesat të realizohen sipas fazave të projektit dhe, për projektet e investimit, një pjesë e pagesës finale të lidhet me verifikimin e rezultateve të arritura.

14. RAPORTIMI

Përfituesi raporton sipas afateve dhe formatit të përcaktuar në marrëveshjen e subvencionit.

14.1 Llojet e raporteve

Përfituesi dorëzon:

- raport progresi (kur kërkohet);
- raport përfundimtar narrativ;
- raport financiar përfundimtar;
- dokumentacionin mbështetës për shpenzimet e realizuara;
- evidencat për rezultatet dhe indikatorët e projektit.

14.2 Përmbajtja e raportit narrativ

Raporti narrativ duhet të përfshijë së paku:

- përshkrimin e aktiviteteve të realizuara;
- rezultatet e arritura;
- indikatorët e përmbushur;
- devijimet eventuale nga plani fillestar;
- sfidat gjatë zbatimit;
- masat e ndërmarra për tejkalimin e tyre;
- fotografi, materiale promovuese ose dëshmi të tjera relevante.

14.3 Raporti financiar

Raporti financiar duhet të paraqesë:

- shpenzimet sipas kategorive buxhetore;
- dokumentet financiare mbështetëse;
- faturat dhe dëshmitë e pagesave;
- tabelën krahasuese ndërmjet buxhetit të miratuar dhe shpenzimeve reale.

14.4 Miratimi i raporteve

Raportet shqyrtohen nga njësia përgjegjëse e MMPH, apo Komisioni përkatës i emëruar nga MMPH.

Nëse raportet nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara, përfituesi njoftohet për plotësimin ose korrigjimin e tyre brenda afatit të caktuar.

15. QËNDRUESHMËRIA DHE SHKALLËZIMI

Aplikuesi duhet të shpjegojë se si do të vazhdojë aktiviteti pas përfundimit të subvencionit, si do të sigurojë mirëmbajtjen e investimit dhe si mund të zhvillohet më tej ideja.

Përparësi mund t'u jepet projekteve që kanë potencial të qartë për rritje, replikim në komuna të tjera, zgjerim të tregut ose tërheqje të investimeve të tjera.

16. MENAXHIMI I RREZIKUT

16.1 Parimet

Përfituesi është përgjegjës për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në realizimin e projektit.

16.2 Rreziqet

Rreziqet mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- vonesat në realizimin e aktiviteteve;
- rritjen e kostove;
- mungesën e furnizimeve;
- pengesat administrative ose ligjore;
- kushtet klimatike;
- mungesën e bashkëpunimit nga partnerët;
- rreziqet financiare;
- rreziqet operative.

16.3 Masat parandaluese

Përfituesi duhet të:

- identifikojë rreziqet kryesore;
- planifikojë masa parandaluese dhe korrigjuese;
- njoftojë menjëherë MMPH për çdo rrezik që mund të ndikojë në realizimin e projektit;
- propozojë ndryshime të arsyeshme, kur është e nevojshme.

16.4 Menaxhimi i ndryshimeve

Çdo ndryshim i rëndësishëm në aktivitetet, afatet ose buxhetin e projektit kërkon miratimin paraprak me shkrim nga MMPH.

17. KONFLIKTI I INTERESIT DHE TRANSPARENCA

- çdo konflikt interesi duhet të deklarohet;
- nuk tolerohen mashtrimi, falsifikimi, korrupsioni, ryshfeti, keqpërdorimi i fond-eve publike ose financimi i dyfishtë;
- MMPH mund të kërkojë kthimin e mjeteve në rast të shkeljeve, në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjen;
- procesi i përzgjedhjes dhe rezultatet e skemës publikohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PARIMI I SKEMËS

VIZIONI ____ ZGJIDHJA ____ RIKIKLIMI/REDUKTIMI I MBETURINAVE ____ REZULTATI I MATSHËM ____ BIZNES I QËNDRUESHËM ____ SHKALLËZIMI

